



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.12.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. Erjon Çela, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.<sup>1</sup>

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 17:30 dhe mbaroi në orën 18:06.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |

<sup>1</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)  
9. *Marçela Shehu* (anëtare)  
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

*Shënim:* Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zonja Naureda Llagami*.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Ermira Lleshi, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike & Përafrimit të Legjislacionit.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z.Erjon Çela, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Objekt i kësaj mbledhjeje të Këshillit të Lartë Gjyqësor është trajtimi i çështjes “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z.Erjon Çela, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje të rendit të ditës është zoti Ilir Toska.

Shkurtimisht parashtrohet se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z.Erjon Çela, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, gjithashtu është përgatitur edhe relacioni shoqërues.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që:

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 27.11.2020, është regjistruar kërkesës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dërguar me shkresën nr.1228 prot., datë 27.11.2020, nëpërmjet të cilës kërkohet caktimi i tre gjyqtarëve për gjykimin e çështjes penale nr. 21/127 Regj. Themeltar, datë 26.09.2020, kundër të pandehurve S.H. etj., bazuar në Vendimin e Këshillit nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sipas preambulës së Vendimit përcaktohet se rregullat sipas këtij vendimi janë të zbatueshme vetëm “në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’ju përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave”.

Aktualisht, në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshilli janë përfshirë tetë gjyqtarë, të cilët, për shkak të nevojave emergjente, janë caktuar në pesë gjykata të juridiksionit të përgjithshëm. Ndër të tjerë, në skemën e delegimit është përfshirë edhe gjyqtari Erjon Çela, i cili kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në kuadër të të cilës ai dhe familjarët e afërt të tij kanë plotësuar dhe dorëzuar rregullisht formularët e vetëdeklarimit për dhënien e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Ndërkohë, asnjë nga gjyqtarët e tjerë të skemës së delegimit nuk ka plotësuar vetëdeklarimet si më lart, duke mos plotësuar kështu kushtet shtesë të sigurisë, siç përcakton shkronja “b”, pika 4, e nenit 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që përcakton plotësimin e kushtit shtesë të sigurisë për t’u caktuar pranë gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Në kushtet kur në listën e gjyqtarëve të skemës së delegimit është vetëm një gjyqtar që plotëson kriteret dhe kushtet për t'u caktuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, referuar pikës 5, të nenit 13, të Rregullores për Kriteret dhe Procedurën e Funkcionimit të Skemës së Delegimit të Gjyqtarit, miratuar me Vendimin e Këshillit nr.22, datë 07.02.2019, Komisioni i Zhvillimit të karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z.Erjon Çela për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në 2 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtari i skemës së delegimit z. Erjon Çela caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar çështjen penale me të pandehur: S.H., etj.; Akuza: “Për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 298/3, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal”.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit Erjon Çela, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi, konkretisht menjëherë dhe publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Hidhet në votim propozimi i ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

*Erjon Muharremaj*: Pro.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Medi Bici*: Pro.

*Maksim Qoku*: Dakord.

Miratohet vendimi “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z.Erjon Çela, për gjykimin e një çështjeje gjyqësore në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 02.12.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 17:30 dhe mbaroi në orën 18:06.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <b>1. Maksim Qoku</b>     | <b>(zëvendëskryetar)</b> |
| <b>2. Medi Bici</b>       | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>3. Fatmira Luli</b>    | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>4. Brunilda Kadi</b>   | <b>(anëtare)</b>         |
| <b>5. Dritan Hallunaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>6. Ilir Toska</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>7. Alban Toro</b>      | <b>(anëtar)</b>          |
| <b>8. Brikena Ukperaj</b> | <b>(anëtar)</b>          |

<sup>2</sup> Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

**9. Marçela Shehu** (anëtare)

**10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

**Shënim:** Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zonja Naureda Llagami**.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 4. Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të përgatitjes së dokumentacionit dhe përfaqësimit në gjykatë.**

#### **RENDI I DITËS:**

2. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Çështja e fundit e rendit të ditës e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska fillimisht relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

A. I. Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë: a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat; b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin; c. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër; ç. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

2. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër: a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë;

3. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

II. Gjykata e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, sipas kësaj radhe: 1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë.

III. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

B. I. Gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm: 1. Gjykata e Apelit Durrës; 2. Gjykata e Apelit Gjirokastrë; 3. Gjykata e Apelit Korçë; 4. Gjykata e Apelit Shkodër; 5. Gjykata e Apelit Vlorë.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat** ka paraqitur nevojë për 9 çështje gjyqësore, lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit (8 gjyqtarët e skemës së delegimit janë caktuar për periudha 1-vjeçare në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm) dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 6.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:



Për 4 çështjet e para, ato nr.1-4, për të cilat kërkohen 1 dhe 3 gjyqtarë, të caktohen 3 të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Në këtë rast, për çështjen nr.1, me short, caktohet dhe relatori.

Për 3 çështjet e dyta, ato nr.5-7, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, të caktohen 2 të tillë, të cilët të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

Për 2 çështjet e fundit, ato nr.8-9, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetarët në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë: z. Petrit Çomo, znj. Alma Kolgjoka.

Në shortimin e 4 çështjeve të para, ato nr.1-4, të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër që është me leje lindje, konkretisht: znj.Nertila Kape.

Në shortimin e çështjes nr.3 dhe 4 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që ka pengesë ligjore për gjykimin e tyre, konkretisht: z. Edvan Veçani.

Në shortimin e 2 çështjeve të fundit, ato nr.8-9, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët në 7 apo më shumë çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: z. Albert Meça; z. Bedri Qori; z. Gerd Hoxha; znj. Ardiana Bera; z. Sokol Tona; z. Kujtim Vraniçi; z. Kreshnik Omari; z. Kastriot Gramshi; z. Sokol Pasho; znj.Vjollca Spahiu; z.Ahmet Metaliaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtar Ardit Kuka.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtar Xhevdet Lika.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Edvan Veçani.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Ardit Kuka (relator), Xhevdet Lika dhe Edvan Veçani (anëtarë).

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarja Arnisa Këlliçi.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarja Enkeleida Hoxha.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarja Arnisa Këlliçi.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtarja Rexhina Merlika.

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarja Oltjona Goxha.

Shorti për dy çështjet e fundit ripërsëritet pasi nuk ishte konsideruar propozimi që anëtarët ranë dakord pak më sipër, që të caktohej një gjyqtar. Nga shorti u zgjodhën dy gjyqtarë nga Gjykata e Tiranës.

Ripërsëritja e shortit si më poshtë:

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtarja Oltjona Goxha.

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarja Oltjona Goxha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Propozimet vijuese sa i përket përjashtimeve nga shorti janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht: Z. Petrit Çomo.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët në 7 (shtatë) apo më shumë çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Albert Meça; Z. Bedri Qori; Z. Gerd Hoxha; Znj. Ardiana Bera; Z. Sokol Tona; Z. Kujtim Vraniçi; Z. Kreshnik Omari; Z. Kastriot Gramshi; Z. Sokol Pasho.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që do të caktohet për të gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, që u caktua më herët znj. Oltiona Goxha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Artan Gjermani dhe Ardian Kalia.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Sa i përket mospërjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Murat Lleshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik për zgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Murat Lleshi dhe Rexhep Karaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti Kryetari në detyrë (Zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, konkretisht: Z. Ded Miri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtar Aurel Arapi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimi vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet Kryetari në detyrë (Zëvendëskryetari) i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: Z.Arbër Çela.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2 penale, gjyqtar Tonin Stërkaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë konkretisht: Znj. Luljeta Kole

Në shortimin e çështjes të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Besnik Shehu; Z. Maksim Qirjazi; Z. Arben Lera; Znj. Ariola Kristo; Z. Markelian Kuqo, z. Seladin Pysqyli, znj. Eglantina Mikani dhe z. Ervin Sulaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Thomaidha Roça.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e kësaj çështjeje të përjashtohet nga shorti Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, konkretisht: Z.Eriol Roshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtar Avni Sejdi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore. Janë kërkuar më parë 3 gjyqtarë.

Sipas propozimit të Komisionit, është vendosur që gjyqtari i skemës së delegimit z. Erjon Çela të caktohet në këtë çështje, kështu që nevoja në këtë rast mbetet për 2 gjyqtarë.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje

gjqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të përzgjidhen, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtarët Esmeralda Xhili dhe Rexhep Bekteshi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit nëntë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës**, ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Kërkesa me nr. rendor 1 e Gjykatës së Apelit Durrës, përmes të cilës kërkohet caktimi i tre gjyqtarëve, është bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë Vendimet nr.401, datë 07.10.2020, “Për komandimin në skemën e delegimit, të gjyqtarës znj.Igerta Hysi”, nr.402, datë 07.10.2020, me të cilin “Gjyqtarja e skemës së delegimit znj.Igerta Hysi caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës për periudhën deri më datë 07.10.2021”, Vendimin 524, datë 27.10.2020, “Për komandimin në skemën e delegimit, të gjyqtarit z.Florjan Kalaja”, si dhe Vendimin nr.525, datë



27.10.2020, me të cilin “Gjyqtari i skemës së delegimit z. Florjan Kalaja caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës për periudhën deri më datë 27.10.2021”. Pra, aktualisht në Gjykatën e Apelit Durrës janë në detyrë dy gjyqtarë, për të cilët në dukje nuk evidentohet ndonjë papajtueshmëri për ushtrimin e funksionit në atë çështje gjyqësore.

Krahas kësaj, nga shqyrtimi i të dhënave të evidentuara në shkresën përcjellëse të kërkesës së Gjykatës së Apelit Durrës, nuk rezulton që dy gjyqtarët e saj Izet Dushaj dhe Anita Mici të jenë në kushtet e padisponueshmërisë ligjore për gjykimin e çështjes, sa kohë nuk rezulton që nga ana e tyre të jetë paraqitur dorëheqje, e cila të jetë miratuar apo që ata të jenë përjashtuar nga gjykimi i çështjes.

Për rrjedhojë, në lidhje me çështjen sipas kërkesës me nr. rendor 1, nuk rezulton që Gjykata e Apelit Durrës të jetë në kushtet e padisponueshmërisë ligjore të të gjithë gjyqtarëve të saj për gjykimin e saj, sa kohë identifikohen katër gjyqtarë për të cilët ligjërisht nuk është deklaruar pasja e ndonjë pengese ligjore.

Në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor ku bazohet kërkesa e Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht në Vendimin nr.30, datë 14.02.2019, Kreu III përcaktohet: “Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë” nënkupton caktimin e një gjyqtari, nga gjykata ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, në një gjykatë tjetër, kur kjo e fundit ka një nevojë konkrete që lidhet me gjykimin e një ose disa çështjeve gjyqësore”, sikurse po ashtu përcaktohet edhe se: “Nevojat e gjykatës” nënkupton mungesën apo padisponueshmërinë ligjore të gjyqtarëve të një gjykate për gjykimin e një apo disa çështjeve gjyqësore”.

Ndaj sa më sipër, është rasti që Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosë refuzimin e kërkesës së Gjykatës së Apelit Durrës, sa i përket kërkesës me numër rendor 1.

Nisur nga rrethanat si më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Refuzimin e shqyrtimit të kërkesës nr.329 prot., datë 28.04.2020, të Gjykatës së Apelit Durrës, për caktim gjyqtari, në çështjen civil me paditës: I.K., etj., të paditur: K.H., etj., me objekt: “Njohje pronar”.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e Komisionit.)

Ndërsa, për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës, sa i përket kërkesës me nr. rendor 2, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimi vijues i Komisionit është:

Për 1 çështje, për të cilën kërkohet 1 gjyqtar, si e përzgjedhur nga shorti të konsiderohet gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, znj. Vojsava Osmanaj, e cila është përzgjedhur me shortin e datës 05.11.2020, për shqyrtimin e të njëjtës kategori kërkesë (për përjashtim gjyqtari) në të njëjtën çështje gjyqësore.

(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimit të Komisioni).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë**, ka paraqitur nevojë për shumë çështje gjyqësore. Ndërkohë, pas caktimit të gjyqtarit Sokol Pina (të skemës së delegimit), rezulton që për 33 çështje për të cilat Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka kërkuar caktimin e gjyqtarit, aktualisht jemi në kushtet që kjo nevojë është plotësuar nëpërmjet caktimit në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë të gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. Sokol Pina. Nisur nga kjo, KZHK i propozon Këshillit që të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të 33 kërkesave (nga nr. 1 – nr. 33) kërkesave të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e Komisionit.)

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, sa i përket kërkesave me nr. rendor 34-36, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ<sup>-së</sup> “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Vlorë, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: Znj. Iliba Bezati.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 34, civile, gjyqtar Nazmi Troka.

Për çështjen nr. 35, civile, gjyqtarët Engert Pëllumbi dhe Nazmi Troka.

Për çështjen nr. 36, penale, gjyqtar Engert Pëllumbi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të njëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë**, ka paraqitur nevojë në 7 çështje në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ<sup>-së</sup> “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të

gjqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 7 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z.Ridvan Hado.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilën nuk ka njoftim nga gjykata për kthimin në detyrë pas përfundimit të lejes afatgjatë të akorduar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe refuzimit të zgjatjes së lejes nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konkretisht: Znj.Evjani Sinojmeri.

Në shortimin e çështjeve civile të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë caktuar më herët për gjykimin e 10 apo më shumë çështjeve gjyqësore, në gjykata të tjera të apelit, konkretisht: Znj. Valdete Hoxha, Z. Shkëlqim Mustafa, Z. Gramoz Levanaj, Z. Genti Shala, Znj.Elvana Lluri, Znj. Elona Toro, Znj.Edlira Petri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarja Zegjine Sollaku.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarja Maria Qirjazi.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarja Zegjine Sollaku.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Maria Qirjazi.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarja Zegjine Sollaku.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarja Maria Qirjazi.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarja Zegjine Sollaku.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dymbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër**, ka paraqitur nevojë në 3 çështje në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht: Z.Desart Avdulaj.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës që janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e 15 apo më shumë çështjeve në gjykata të tjera të apelit, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z.Izet Dushaj; Znj.Anita Mici; Z.Valbon Çekrezi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarja Igerta Hysi.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarët Florjan Kalaja dhe Igerta Hysi.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtar Florjan Kalaja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të trembëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë**, ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, 1 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga Kryetari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, konkretisht: Z.Dritan Banushi.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë që është anëtare e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht: Znj.Miranda Andoni.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Irena Brahim

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Sokol Pina.

Me kaq mbyllen në tërësi procedurat e shortit.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**